



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHËRBIMI INFORMATIV I SHTETIT**

Kopje nr. 1
RHK

U R D H Ë R

Nr. 20 – 69, datë 28/04/2015

“PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË SHISH”

Në zbatim të nenit 13 të ligjit nr.8391, datë 28/10/1998 “Për Shërbimin Informativ Kombëtar”, i ndryshuar, dhe neneve 4, 7, 8 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

U R D H Ë R O J :

- 1.** Miratimin e programit të transparencës së SHISH, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur.
- 2.** Miratimin e modeleve, bashkëlidhur, që do të përdoren nga SHISH, si vijon:
 - a) Model Nr.1 - “Kërkesë për informacion”;
 - b) Model Nr.2 - “Përgjigja për informacionin e kërkuar”;
 - c) Model Nr.3 - “Mbi refuzimin e formës së kërkuar të informacionit/dokumentacionit”;
 - d) Model Nr.4 - “Mbi zgjatjen e afatit të kthimit të përgjigjes”;
 - e) Model Nr.5 - “Njoftim për fillimin e procedurës për rishikim të dokumentacionit të klasifikuar dhe shtyrje të afatit”.
- 3.** Krijimin e një regjistri të posaçëm publik, sipas lidhjes nr. 2, bashkëlidhur, ku të pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre, pa pasqyruar identitetin e kërkuarit të informacionit.

-
4. Regjistri i posaçëm të publikohet në faqen e internetit në adresën www.shish.gov.al, si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Përditësimi i tij të bëhet çdo tre muaj.
 5. Me njohjen e këtij urdhri ngarkohen të gjithë punonjësit e SHISH në AQ dhe në bazë.
 6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Kabineti i Drejtorit të SHISH, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore.
 7. Kontrolli për zbatimin e këtij urdhri të bëhet nga Drejtori i Kabinetit të Drejtorit të SHISH.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI

VISHO AJAZI LIKA